



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:111991
Datë: 30.11.2021
Numri i dokumentit: 02449732

PA1.nr.972/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Zyhdi Haziri dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ardianë Morina, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. S, nga fshati ..., Obiliq, për shkak të veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365, lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës, (KPRK-së), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore, në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.504/2020 të datës 19.04.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.10.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore, në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, **ANULOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore, në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.504/2020 i datës 19.04.2021, dhe kjo çështje penale i kthehet Gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.504/2020 datë 19.04.2021, e ka liruar nga akuza të akuzuarin B. S, për shkak të veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365 lidhur me par.1 të KPRK-së. Mbrojtësi i të pandehurit për shpenzimet e kërkuara lidhur me këtë çështje penale udhëzohet në kontest të rregullt civil. Pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore, në Mitrovicë, për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe aktgjykimit lirues, me propozim që Gjykata e Apelit, në Prishtinë, ta aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm P.nr.504/2020 të datës 19.04.2021, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptoj masë efektive në përputhje me ligjin.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.989/2021, të datës 30.07.2021, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm, të aprovohet si e bazuar, ndërsa të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm ,P.nr.504/2020 i datës 19.04.2021, dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, analizoj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Me ankesë Prokurori i Prokurorisë Themelore, në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, aktgjykimin e ankimon për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se ka ekzistuar prishja e rrjetit, e të cilën disa herë, e ka paraqitur i dëmtuari Sh. A, ndërsa gjykata fajësinë e ka gjuajtur- orientuar në të dëmtuarin edhe pse është tërësisht e qartë se prishja ka ekzistuar, andaj në ankesë prokurori thekson se gjykata e shkallës së parë faktet vendimtare i ka vërtetuar gabimisht e disa jo plotësisht e me vetë këtë ka sjellë vendimin e gabuar të lirimit nga akuza, sepse në rast se i njëjti do të kishte kujdes në të gjitha detajet dhe faktet relevante dhe provave, në asnjë rast nuk do të mund të sjellë aktgjykim te cilin e ka sjellë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe aktgjykimin e atakuar, ka gjetur dhe ka vërtetuar se i njëjti është përfshirë me shkelje esenciale, e të cilin aktgjykim e bëjnë kundërthënës me saktësinë e provave, që janë kundërthënës në mes veti dhe me fakte ekzistuese, siç vërehet nga vet shkresat e lëndës.

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit, e duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP, kolegji penal i Gjykatës së Apelit, vlerëson se aktgjykimi i ankimon, duhet

të anulohet dhe kjo çështje penale duhet që t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim, pasi që aktgjykimi në fjalë, është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase gjykata duhet analizuar çdo provë veç e veç, duke përfshirë tërsinë e tyre dhe saktësinë e provave kundërthënëse, nga neni 384 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.12, e lidhur me nenin 370 paragrafët 6 dhe 7, të KPPK-së.

Aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar sipas ligjit, dispozitivi i të njëjtit është i paqartë, përmban mangësi të theksuara. Gjithashtu, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar, është në kundërshtim me arsyetimin, si dhe me shkresat tjera të lëndës, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, nuk janë paraqitur arsye të qarta dhe të mjaftueshme, përkitazi me faktet vendimtare në këtë çështje juridiko-penale.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit, vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, nuk ka arritur që në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme të vlerësojë të gjitha faktet që janë të rëndësishme për të nxjerr më pas konkluzione të drejta në lidhje me faktet vendimtare, e më pas për të marr vendim të drejtë në këtë çështje, sepse konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, në lidhje me faktet vendimtare që i referohen përgjegjësisë penale të akuzuarit B. S, nuk janë arsyetuar mjaftueshëm, andaj si të tilla tani për tani nuk janë të pranueshme nga ana e Kolegjit të Gjykatës së Apelit, sepse gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj nuk ka arritur në mënyrë të hollësishme dhe përmbajtjesore të bëjë vlerësimin e të gjitha provave një nga një dhe në lidhje me provat tjera, në mënyrë që në bazë të një vlerësimi të tillë të nxjerr konkludim nëse faktet konkrete vendimtare janë provuar ashtu siç parasheh neni 361 par.2, të KPPK-së. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë është dashur të bëjë vlerësimin në mënyrë të veçantë për të vërtetuar gjendjen faktike dhe Kolegji i gjykatës së Apelit, duke u bazuar në deklaratën e të akuzuarit B. S, të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor, se gjatë vitit 2013, i dëmtuari kishte ndërhyre në rrjetin elektrik të cilin kishte pranuar edhe një foto nga dëshmitari F. për ndërhyrjen në rrjetin elektrik nga i dëmtuari në kohën kur është bërë transferimi nga KEK-u në KEDS, deklarata e dhënë e dëshmitarit A. N, të dhënë në seancë të shqyrtimit kryesor se përçuesit- të rrjetit energjisë elektrike kanë qenë të pa shtrënguara dhe në ditën kritike ka pasur një erë të fortë ku nga presioni i ajrit përçuesit kanë lëvizur duke kontaktuar mes veti dhe prodhuar flakë, deklarata e H. B, se në ditën kritike është lajmëruar për prishje në vend të ngjarjes ka pasur dëme materiale, deklarata dëshmitarit F. Z, se sëbashku me ekipin e KEDS-it, kam qenë në vend ngjarjes, në fshatin G..., Komuna e Vushtrisë, ku kam vërejtur se janë shkaktuar dëme materiale konsumatorit, andaj Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke analizuar dëshmitë e dëshmitareve dhe provat materiale që

janë shtjelluar në këtë çështje juridiko- penale, ka gjetur dhe vërtetuar se gjykata në shkallë të parë, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, sepse nga shkresat e lëndës ekziston formulari i KEDS-it, mbi lajmërimin e prishjes së rrjetit nga konsumatori- i dëmtuari dhe atë 2 muaj para ditës kritike të rastit të ndodhur, gjegjësisht me datë 17.07.2017, ndërsa rasti ka ndodhur me 19.09.2017, e në të njëjtin formular është shprehur rreziku nga përçuesit, që do të thotë se deri në ditën kritike a është ndërmarr ndonjë veprim nga ekipi i KEDS-it, për sanimin apo edhe shikimin e vendit të ngjarjes por nëse është ndërmarr ndonjë veprim, mungon procesverbali në shkresa të lëndës. Njëherit gjykata e shkallës së parë ka administruar edhe ekspertizën për të cilën fare nuk i ka besuar të njëjtës me arsyetim se e njëjta ekspertizë është bërë nga eksperti i elektronikës, dhe me të drejtë nuk iu ka falur besimi, që do të thotë se kolegji i Gjykatës së Apelit, mendon se duhet të caktohet eksperti i fushës së energjetikës dhe i njëjti ka për të konstatuar se çfarë tensioni kanë pasur përçuesit në vend të ngjarjes, se a kanë qenë përçuesit të lirë me tepër se toleranca e lejuar, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka proceduar si provë edhe formularin mbi lajmërimin e prishjes nga konsumatori- i dëmtuari dhe i akuzuari në seancë të shqyrtimit ka deklaruar se fare nuk e ka vërejtur këtë formular të deponuar në KEDS, nga konsumatori, para ditës kritike.

Atëherë gjykata në shkallë të parë, duhet që në rigjykim, të shikojë se nga kush është pranuar ky formular nga punëtorët e KEDS-it, dhe të dëgjohet i njëjti si dëshmitar, se a është njoftuar përgjegjësi për sanimin e rrjetit të energjisë elektrike.

Në aktgjykimin e shkallës së parë në arsyetimin e saj, sa i përket kohës së ngritjes së aktakuzës, për të cilën është bazuar në qëndrimin juridik të Gjykatës Supreme, të datës 10.11.2016, me nr.583/16, për të verifikuar kohën e fillimit dhe përfundimit të hetimeve, kolegji ka analizuar dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë është thirrur në të njëjtin mendim për ta liruar të akuzuarin nga akuza, që do të thotë se vetë arsyetimi i aktgjyimit të shkallës së parë është kundërtë në mes veti, se gjykata e shkallës së parë ka elaboruar provat e kësaj çështje penale gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ndërsa në anën tjetër është thirr edhe në qëndrimin juridik të Gjykatës Supreme, e më pas është liruar nga akuza i akuzuari, dhe për atë, konform dispozitave ligjore në fuqi, të KPPK-së, me aktvendim para urdhrin ndëshkimor është pasur mundësia për të shikuar mundësinë për hudhjen e të njëjtës aktakuzë, gjegjësisht mëse janë plotësuar kushtet ligjore të tilla, e nga shkresat e lëndës është vërtetuar se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka shqyrtuar një veprim të tillë, por e njëjta nuk është shqyrtuar nga gjykata e shkallës së parë, por ka vazhduar me shqyrtimin e provave për këtë çështje juridiko- penale.

Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit penal, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të gjitha këto përbëjnë shkelje të dispozitave të procedurës penale, që kanë për pasojë edhe vërtetimin jo te plotë të gjendjes faktike, të cilin aktgjykim e bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm dhe të cilat domosdoshmerisht edhe kanë kushtëzuar anulimin e këtij aktgjykimi, ngase nga këto shkelje nuk ka mundur me bërë ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar, nga ana e kolegjit të kësaj gjykate.

Duke u bazuar në të gjitha këto shkelje të evidentuara, kolegji penal i kësaj gjykate, vendosi që të njëjtin aktgjykim ta anuloje dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, duhet të caktojë shqyrtimin gjyqësor, të evitojë shkeljet dhe të metat e lartcekura, duke administruar dhe shqyrtuar të gjitha provat, të cilat duhet të vlerësohen, duke u bazuar në nenin 361 par.2 të KPK-së, e më pas të nxjerr konkludim të drejtë përkitazi me faktet vendimtare, duke marr një vendim gjyqësor, i cili duhet të përpilohet sipas nenit 370 të KPPK-së, duke marr ne konsiderate edhe vërejtjet e lartshënuara.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 402 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1. të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.972/21, më datën 12.10.2021

Bashkëpunëtorja profesionale

Ardianë Morina

Anëtarët e kolegjit:

Zyhdi Haziri

Ferit Osmani

Kryetar i kolegjit,

Hashim Çollaku
